

**31988L0357**

**Direktiva e dytë e Këshillit 88/357/KEE, datë 22 qershor 1988, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, ku parashikohen dispozitat për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime dhe ku ndryshohet Direktiva 73/239/KEE**

*Gazeta Zyrtare L 172 , 04/07/1988 fq. 0001 - 0014*

*Botimi i posaçëm në gjuhën finlandeze: Kapitulli 6 Vëllimi 2 fq. 0175 Botimi i posaçëm në gjuhën suedeze Kapitulli 6 Vëllimi 2 fq. 0175*

DIREKTIVA E DYTË E KËSHILLIT, datë 22 qershor 1988, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, ku parashikohen dispozitat për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime dhe ku ndryshohet Direktiva 73/239/KEE (88/357/KEE)

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 57 paragrafi 2 dhe nenin 66 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Në bashkëpunim me Parlamentin Europian [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [3],

Meqë është e nevojshme të zhvillohet tregu i brendshëm i sigurimeve dhe, për arritjen e këtij objektivi, është e dëshirueshme t'u bëhet më e lehtë ndërmarrjeve të sigurimeve me zyrë qendrore brenda Komunitetit, që të ofrojnë shërbime në Shtetet Anëtare, duke u dhënë kështu mundësi policëmbajtësve t'u drejtohen jo vetëm siguruesve të vendosur në vendin e tyre por edhe siguruesve me zyrë qendrore brenda Komunitetit e të vendosur në Shtetet Anëtare të tjera;

Meqë, në zbatim të Traktatit, pas përfundimit të periudhës kalimtare është i ndaluar çdo diskriminim në lidhje me lirinë për të ofruar shërbime për shkak të mosvendosjes së ndërmarrjes në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet; meqë ky ndalim i diskriminimit zbatohet për shërbimet që ofron çdo subjekt i Komunitetit, pavarësisht nëse është zyra qendrore e një ndërmarrjeje apo një agjenci a degë;

Meqë, për arsye praktike, është e dëshirueshme të përkufizohet ofrimi i shërbimeve duke marrë në konsideratë si vendndodhjen e ofruesit ashtu edhe vendndodhjen e riskut; meqë, për rrjedhojë, është mirë të miratohet edhe një përkufizim i vendndodhjes së riskut; për më tepër, meqë është e dëshirueshme të bëhet dallimi midis veprimtarisë së zhvilluar nëpërmjet vendosjes dhe veprimtarisë së zhvilluar nëpërmjet lirisë për të ofruar shërbime;

Meqë është e dëshirueshme të plotësohet Direktiva e Parë e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative të lidhura me fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës [4], e quajtur më tej në këtë direktivë "Direktiva e parë", me shtesat dhe ndryshimet e bëra me Direktivën 87/343/KEE [5], për të sqaruar sidomos kompetencat dhe mjetet e mbikëqyrjes të cilat u jepen autoriteteve mbikëqyrëse; meqë është po ashtu e dëshirueshme të parashikohen dispozita specifike për fillimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së kryer nëpërmjet lirisë për të ofruar shërbime;

Meqë policëmbajtësve të cilët, për shkak të statusit e madhësisë së tyre a për shkak të natyrës së riskut që kërkohet të sigurohet, nuk kërkojnë mbrojtje të veçantë në Shtetin ku ndodhet risku është mirë t'u jepet liri e plotë për të pasur një treg sa më të gjerë të sigurimeve; për më tepër, meqë është e dëshirueshme t'u garantohet mbrojtje adekuate policëmbajtësve të tjerë;

Meqë interesi për të mbrojtur policëmbajtësit dhe për të shmangur çdo cenim të konkurrencës e justifikon bashkërendimin e lehtësimit të rregullave për aktivet e përputhura, të parashikuara me Direktivën e parë;

Meqë vazhdojnë të jenë të ndryshme dispozitat në fuqi në Shtetet Anëtare në lidhje me legjislacionin e kontratave të sigurimit; meqë në raste të caktuara mund të ofrohet liria për të zgjedhur si legjislacion të zbatueshëm për kontratën një legjislacion të ndryshëm nga ai i shtetit ku ndodhet risku, në përputhje me rregullat që marrin në konsideratë rrethanat e veçanta;

Meqë objekti i kësaj direktive është mirë të përfshijë sigurimet e detyrueshme por të kërkojë që kontratat për këto sigurime të jenë në përputhje me dispozitat specifike të lidhura me këto sigurime, të parashikuara nga Shteti Anëtar që vendos detyrimin për t'u siguruar;

Meqë është mirë të përforcohen dispozitat e Direktivës së parë për transferimin e portofolit dhe të plotësohen me dispozita që mbulojnë në mënyrë të posaçme transferimin tek një ndërmarrje tjetër, e portofolit të kontratave të lidhura për ofrimin e shërbimeve;

Meqë objekti i dispozitave që kanë të bëjnë konkretisht me lirinë për të ofruar shërbime është mirë të përjashtojë disa risqe të caktuara, zbatimi mbi të cilat i dispozitave në fjalë bëhet i papërshtatshëm në këtë fazë për shkak të rregullave specifike të miratuara nga autoritetet e Shteteve Anëtare, për shkak të natyrës dhe rrjedhëve shoqërore të dispozitave të tilla; meqë, për rrjedhojë, është mirë të rishqyrtohen këto përjashtime pas një periudhe të caktuar pasi kjo direktivë të ketë qenë në fuqi;

Meqë, në interes të mbrojtjes së policëmbajtësve, është mirë që në këtë fazë të tanishme të bashkërendimit t'u jepet Shteteve Anëtare mundësia e kufizimit të kryerjes së njëkohshme të veprimtarisë nëpërmjet lirisë për të ofruar shërbime dhe të veprimtarisë nëpërmjet vendosjes; meqë nuk mund të parashikohet asnjë kufizim i tillë kur policëmbajtësit nuk e kërkojnë këtë mbrojtje;

Meqë, ushtrimi i lirisë për të ofruar shërbime është mirë t'u nënshtrohet procedurave që garantojnë përmbushjen, nga ana e ndërmarrjes së sigurimeve, e dispozitave që kanë të bëjnë

si me garancitë financiare ashtu edhe me kushtet e sigurimeve; meqë këto procedura mund të lehtësohen në rastet kur veprimtaria nëpërmjet ofrimit të shërbimeve i mbulon policëmbajtësit që, për shkak të statusit dhe madhësisë së tyre apo për shkak të riskut që kërkohet të sigurohet, nuk kërkojnë mbrojtje shoqërore në shtetin ku ndodhet risku;

Meqë është e nevojshme të fillojë një bashkëpunim i posaçëm në lidhje me ofrimin e shërbimeve ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse kompetente dhe ndërmjet këtyre autoriteteve dhe Komisionit; meqë është mirë të parashikohet një sistem sanksionesh që duhen zbatuar atëherë kur ndërmarrjet që ofrojnë shërbime nuk i përmbushin dispozitat e Shtetit Anëtar ku ofrohet shërbimi;

Meqë, në pritje të bashkërendimit të ardhshëm, është mirë që rezervat teknike t'u nënshtrohen rregullave dhe mbikëqyrjes të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet, kur ky ofrim i shërbimeve përfshin risqe në lidhje me të cilat shteti pritës i shërbimit dëshiron të parashikojë mbrojtje të veçantë për policëmbajtësit; por sidoqoftë, nëse nuk justifikohet ky interes për të mbrojtur policëmbajtësit, rezervat teknike vazhdojnë të jenë objekt i rregullave dhe mbikëqyrjes nga Shteti Anëtar ku është vendosur siguresi;

Meqë disa Shtete Anëtare nuk ia nënshtrojnë transaksionet e sigurimeve asnjë tatimi të tërthortë, ndërsa shumica zbatojnë tatime të posaçme dhe forma të tjera kontributesh, duke përfshirë tarifatat shtesë të planifikuara për organet e dëmshpërblimit; meqë struktura dhe shkalla e këtyre tatimeve dhe kontributeve janë të ndryshme në Shtete Anëtare të ndryshme ku zbatohen; meqë është e dëshirueshme të shmangët situata ku dallimet ekzistuese sjellin prishje të konkurrencës në shërbimet e sigurimeve mes Shteteve Anëtare; meqë, në pritje të harmonizimit të ardhshëm, këtë problem ka të ngjarë ta korrigjojë zbatimi i sistemit tatimor dhe i formave të tjera të kontributeve të parashikuara nga Shteti Anëtar ku ndodhet risku, dhe meqë u takon Shteteve Anëtare të vendosin mënyrën për të siguruar mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve të tilla;

Meqë është e dëshirueshme që zbatimi jo i bashkërenduar i kësaj direktive dhe i Direktivës së Këshillit 78/473/KEE, datë 30 maj 1978, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me bashkësigurimin në Komunitet [6] të mos lejohet të çojë në tre sisteme të ndryshme në çdo Shtet Anëtar; meqë, për rrjedhojë, është mirë që kriteret që përcaktojnë "risqet e mëdha" në këtë direktivë të përcaktojnë edhe risqet që ka të ngjarë të mbulohen me rregullimet e bashkësigurimit në Komunitet;

Meqë është e dëshirueshme të merret në konsideratë, sipas kuptimit të nenit 8 c të Traktatit, shkalla e punës që duhet të bëjnë disa ekonomi të caktuara që shfaqin dallime sa i takon zhvillimit; meqë, për rrjedhojë, është e dëshirueshme t'u lejohen disa Shteteve Anëtare të caktuara rregullime kalimtare për zbatimin gradual të dispozitave specifike të kësaj direktive në lidhje me lirinë për të ofruar shërbime,

**KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:**

## TITULLI I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

## Neni 1

Objekti i kësaj direktive është:

- (a) plotësimi i Direktivës së parë 73/239/KEE;
- (b) parashikimi i dispozitave të veçanta në lidhje me lirinë për të ofruar shërbime për ndërmarrjet dhe në lidhje me klasat e sigurimeve që mbulon Direktiva e parë.

## Neni 2

Për qëllimet e kësaj direktive:

- (a) "Direktiva e parë" është:

Direktiva 73/239/KEE;

- (b) "ndërmarrje":

- për qëllimet e zbatimit të Titullit I dhe II, është:

çdo ndërmarrje që ka marrë autorizimin zyrtar sipas nenit 6 ose 23 të kësaj direktive,

- për qëllimet e zbatimit të Titullit III dhe V, është:

çdo ndërmarrje që ka marrë autorizimin zyrtar sipas nenit 6 të kësaj direktive,

- (c) "subjekt":

është zyra qendrore, agjencia a dega e një ndërmarrjeje, duke mbajtur në konsideratë nenin 3;

- (d) "Shteti Anëtar ku ndodhet risku" është:

- Shteti Anëtar në të cilin ndodhet prona, kur sigurimet kanë të bëjnë me ndërtesa ose me ndërtesa dhe përmbajtja e tyre, për aq sa këtë përmbajtje e mbulon e njëjta policë sigurimi,

- Shteti Anëtar ku është bërë regjistrimi, kur sigurimet kanë të bëjnë me automjete të çdo lloji,

- Shteti Anëtar ku e ka marrë policën policëmbajtësi në rastin e policave me kohëzgjatje katër muaj ose më pak që mbulojnë risqet e udhëtimit dhe pushimeve, pavarësisht në cilën klasë bien,

- Shteti Anëtar ku ka vendbanimin kryesor policëmbajtësi, nëse policëmbajtësi është person juridik, Shteti Anëtar ku ndodhet subjekti i policëmbajtësit me të cilin lidhet kontrata, në të gjitha rastet e mbuluara shprehimisht nga nënpikat më lart;

- (e) "Shtet Anëtar i subjektit" është:

- Shteti Anëtar ku ndodhet subjekti që mbulon riskun;

- (f) "Shteti Anëtar ku ofrohen shërbimet" është:

Shteti Anëtar ku ndodhet risku kur e mbulon subjekti i ndodhur në një Shtet Anëtar tjetër.

### Neni 3

Në kuptim të Direktivës së parë dhe të kësaj direktive, çdo prezencë e përhershme e një ndërmarrjeje në territorin e një Shteti Anëtar trajtohet në të njëjtën mënyrë me një agjenci apo degë, edhe sikur kjo prezencë të mos marrë formën e një dege apo agjencie, por të konsistojë vetëm në një zyrë të administruar nga personeli i vetë ndërmarrjes ose nga një person i pavarur, por me autoritet të përhershëm për të vepruar për llogari të ndërmarrjes njësoj siç do të vepronte edhe një agjenci.

### Neni 4

Në kuptim të kësaj direktive dhe Direktivës së parë, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të policës nuk përfshijnë kushtet specifike që synojnë të përmbushin, në një rast specifik, rrethanat e veçanta të riskut që kërkohet të mbulohet.

## TITULLI II

### DISPOZITA NË PLOTËSIM TË DIREKTIVËS SË PARË

### Neni 5

Në nenin 5 të Direktivës së parë bëhet shtesa e mëposhtme:

"(d) "risqe të mëdha" janë:

ii(i) risqet e klasifikuara në klasat 4, 5, 6, 7, 11 dhe 12 të shkronjës "A" të shtojcës;

i(ii) risqet e klasifikuara në klasat 14 dhe 15 të shkronjës "A" të shtojcës, kur policëmbajtësi është i angazhuar profesionalisht në një veprimtari industriale a tregtare apo në njërin prej profesioneve të lira, dhe risqet e lidhura me një veprimtari të tillë;

(iii) risqet e klasifikuara në klasat 8, 9, 13 dhe 16 të shkronjës "A" të shtojcës për aq sa policëmbajtësi i tejkalon kufijtë e të paktën dy prej tre kritereve të mëposhtme:

faza e parë: deri më 31 dhjetor 1992:

- shuma gjithsej e bilancit: 12,4 milion Ecu,
- të ardhura neto: 24 milion Ecu,
- numri mesatar i punëmarrësve gjatë vitit financiar: 500.

faza e dytë: nga 1 janar 1993:

- shuma gjithsej e bilancit: 6,2 milion Ecu,
- të ardhura neto: 12,8 milion Ecu,
- numri mesatar i punëmarrësve gjatë vitit financiar: 250.

Nëse policëmbajtësi i përket një grupi ndërmarrjesh për të cilin përgatiten llogari të konsoliduara sipas kuptimit të Direktivës 83/349/KEE (7), kriteret e lartpërmendura zbatohen në bazë të llogarive të konsoliduara.

Secili Shtet Anëtar mund t'u shtojë kategorive të përmendura në nënpikën "iii" risqet që sigurojnë shoqatat profesionale, sipërmarrjet e përbashkëta apo grupimet e përkohshme.”

#### Neni 6

Në kuptim të zbatimit të paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 14 dhe të nenit 24 të Direktivës së parë, Shtetet Anëtare respektojnë Shtojcën 1 të kësaj direktive sa u takon rregullave të përputhjes.

#### Neni 7

1. Legjislacioni i zbatueshëm për kontratat e sigurimeve të përmendura në këtë direktivë në mbulim të risqeve që ndodhen në Shtetet Anëtare përcaktohet në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

(a) Kur policëmbajtësi vendbanimin e përhershëm apo administratën qendrore e ka brenda territorit të Shtetit Anëtar ku ndodhet risku, legjislacioni që zbatohet për kontratën e sigurimit është legjislacioni i këtij Shteti Anëtar. Por, kur e lejon legjislacioni i Shtetit Anëtar, palët mund të zgjedhin legjislacionin e një vendi tjetër.

(b) Kur policëmbajtësi nuk e ka vendbanimin e përhershëm apo administratën qendrore në Shtetin Anëtar ku ndodhet risku, palët e kontratës së sigurimit mund të vendosin të zbatojnë ose legjislacionin e Shtetit Anëtar ku ndodhet risku ose legjislacionin e vendit ku policëmbajtësi ka vendbanimin kryesor apo administratën qendrore.

(c) Kur policëmbajtësi ushtron një veprimtari tregtare a industriale apo një profesion të lirë dhe kur kontrata mbulon dy a më shumë risqe të lidhura me këto veprimtari dhe të ndodhura në Shtete Anëtare të ndryshme, liria e zgjedhjes së legjislacionit të zbatueshëm për kontratën përfshin legjislacionet e këtyre Shteteve Anëtare dhe të vendit ku policëmbajtësi ka vendbanimin e përhershëm apo administratën qendrore.

(d) Pavarësisht shkronjave "b" dhe "c", kur Shtetet Anëtare të përmendura në to japin një liri më të madhe për zgjedhjen e legjislacionit të zbatueshëm për kontratën, palët mund ta shfrytëzojnë këtë liri.

(e) Pavarësisht shkronjave "a", "b" dhe "c", kur risqet që mbulon kontrata kanë të bëjnë vetëm me ngjarje që ndodhin në një Shtet Anëtar që nuk është Shteti Anëtar ku ndodhet risku, sipas përkufizimit në nenin 2 shkronja "d", palët mund të zgjedhin legjislacionin e shtetit të parë.

(f) Për risqet e përmendura në nenin 5 shkronja "d" nënpika "i" të Direktivës së parë, palët e kontratës mund të zgjedhin cilin legjislacion të duan.

(g) Fakti që, në rastet e përmendura në shkronjat "a" ose "f", palët kanë zgjedhur një legjislacion nuk e cenon zbatimin e rregullave të detyrueshme të Shtetit Anëtar, kur të gjitha elementet e tjera të lidhura me situatën në momentin e zgjedhjes lidhen vetëm me Shtetin Anëtar, çka do të thotë rregullat nga të cilat Shteti Anëtar nuk lejon asnjë përjashtim nëpërmjet një kontrate.

(h) Zgjedhja e përmendur në shkronjat e mësipërme duhet të shprehet apo dëshmohet me qartësi të arsyeshme me anë të kushteve të kontratës apo të rrethanave të rastit. Nëse nuk bëhet kështu apo nëse nuk është bërë asnjë zgjedhje, kontrata rregullohet me legjislacionin e vendit, nga vendet që merren parasysh në shkronjat më lart, me të cilin ka më shumë lidhje kontrata. Megjithatë, një pjesë individuale e kontratës që ka një lidhje më të ngushtë me një vend tjetër, nga vendet që merren parasysh në shkronjat më lart, mund të rregullohet, përjashtimisht, me legjislacionin e këtij vendi tjetër. Sipas një supozimi, që mund të kundërshtohet, kontrata konsiderohet se është e lidhur më ngushtë me Shtetin Anëtar ku ndodhet risku.

(i) Kur një shtet ka disa njësi territoriale, secila prej të cilave ka rregullat e veta ligjore në lidhje me detyrimet kontraktore, secila njësi konsiderohet si një vend në kuptimin e identifikimit të legjislacionit të zbatueshëm sipas kësaj direktive.

Shteti Anëtar në të cilin disa njësi të ndryshme territoriale kanë rregullat e veta ligjore në lidhje me detyrimet kontraktore nuk është i detyruar t'i zbatojë dispozitat e kësaj direktive për konfliktet që lindin midis legjislacioneve të njëjësive në fjalë.

2. Asnjë parashikim i këtij neni nuk e pengon zbatimin e rregullave ligjore të forumit kur janë të detyrueshme, pavarësisht nga legjislacioni që zbatohet përndryshe për kontratën.

Nëse e përmban legjislacioni i Shtetit Anëtar, mund të zbatohen rregullat e detyrueshme të legjislacionit të Shtetit Anëtar ku ndodhet risku apo të Shtetit Anëtar që vendos detyrimin për të marrë sigurim në qoftë se dhe për sa kohë që, sipas legjislacionit të këtyre shteteve, duhen zbatuar medoemos këto rregulla pavarësisht legjislacionit të zbatueshëm për kontratën.

Kur kontrata mbulon risqe që ndodhen në më shumë se një Shtet Anëtar, kjo kontratë, sipas kuptimit të zbatimit të kësaj pike, konsiderohet se përbëhet nga disa kontrata, ku secila lidhet vetëm me njërin Shtet Anëtar.

3. Në varësi të pikave më lart, Shtetet Anëtare zbatojnë për kontratat e sigurimeve të përmendura në këtë direktivë rregullat e tyre të përgjithshme të së drejtës private ndërkombëtare në lidhje me detyrimet kontraktore.

## Neni 8

1. Sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, ndërmarrjet e sigurimeve mund të ofrojnë dhe të lidhin kontrata të sigurimeve të detyrueshme në përputhje me rregullat e kësaj direktive dhe të Direktivës së parë.

2. Nëse Shteti Anëtar vendos një detyrim për të marrë sigurim, kontrata nuk quhet se e ka përmbushur këtë detyrim nëse nuk është në përputhje me dispozitat specifike që lidhen me sigurimin në fjalë të parashikuara nga Shteti Anëtar.

3. Nëse, në rastin e sigurimeve të detyrueshme, legjislacioni i Shtetit Anëtar ku ndodhet risku bie ndesh me legjislacionin e Shtetit Anëtar që vendos detyrimin për të marrë sigurim, epërsi ka ky i fundit.

4. (a) Në varësi të shkronjave "b" dhe "c" të kësaj pike, zbatohet paragrafi i tretë i pikës 2 të nenit 7 kur kontrata e sigurimit ofron mbulim në disa Shtete Anëtare nga të cilat të paktën njëri vendos një detyrim për të marrë sigurim.

(b) Shteti Anëtar i cili më datën e njoftimit të kësaj direktive kërkon që çdo ndërmarrje e vendosur në territorin e tij duhet të marrë aprovim për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimeve të detyrueshme mundet që, përjashtimisht nga neni 9 dhe 18, të kërkojë edhe që këto kushte të aprovohen për çdo ndërmarrje sigurimesh që ofron një mbulim të tillë brenda territorit të tij sipas kushteve të parashikuara në nenin 12 pika 1.

(c) Shteti Anëtar mundet që, përjashtimisht nga neni 7, të parashikojë që legjislacioni i zbatueshëm për kontratën e sigurimit të detyrueshëm të jetë legjislacioni i Shtetit që vendos detyrimin për marrjen e sigurimit.

(d) Kur Shteti Anëtar kërkon marrjen e një sigurimi të detyrueshëm dhe kur siguruesi duhet të njoftojë autoritetet kompetente për pushimin e mbulimit, ky pushim mund të përdoret kundrejt të tretëve të dëmtuar vetëm në rrethanat e parashikuara në legjislacionin e shtetit në fjalë.

5. (a) Çdo Shtet Anëtar i komunikon Komisionit risqet për të cilat është i detyrueshëm sigurimi në zbatim të legjislacionit të tij, duke deklaruar:

- dispozitat konkrete ligjore që lidhen me sigurimin,

- të dhënat që duhen dhënë në certifikatën që duhet t'i lëshojë siguruesi personit të siguruar nëse shteti kërkon vërtetim të përmbushjes së detyrimit për të marrë sigurim të detyrueshëm. Shteti Anëtar mund të kërkojë që në këto të dhëna të përfshihet edhe një deklaratë e siguruesit për përmbushjen e dispozitave specifike në lidhje me këtë sigurim nga ana e kontratës.

(b) Komisioni i publikon të dhënat e përmendura në shkronjën "a" në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

(c) Shteti Anëtar pranon si provë të përmbushjes së detyrimit për të marrë sigurim një certifikatë përmbajtja e së cilës është në përputhje me nënpikën e dytë të shkronjës "a".

## Neni 9

1. Paragrafi i fundit i nenit 9 dhe paragrafi i fundit i nenit 11 pika 1 të Direktivës së parë zëvendësohen si më poshtë:



"Megjithatë, informacioni i përmendur në shkronjën "a" dhe "b" në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta dhe në lidhje me shkallën e primeve nuk kërkohet në rastin e risqeve të përmendura në nenin 5 shkronja "d"." 2. Neni 8 pika 3 dhe neni 10 pika 3 të Direktivës së parë zëvendësohen si më poshtë:

"3. Ky bashkërendim nuk i pengon Shtetet Anëtare të mbajnë ose të miratojnë akte ligjore, nënligjore apo administrative në veçanti në lidhje me domosdoshmërinë që administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit të plotësojnë kualifikime teknike dhe në lidhje me aprovimin e statutit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policave të sigurimit, shkallëve të primeve dhe të çdo dokumenti tjetër të nevojshëm për ushtrimin normal të mbikëqyrjes.

Megjithatë, në lidhje me risqet e përmendura në nenin 5 shkronja "d", Shtetet Anëtare nuk parashikojnë dispozita që të kërkojnë aprovimin apo njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policave, shkallëve të primeve apo formularëve e dokumenteve të tjera të shtypura që mendon të përdorë ndërmarrja në marrëdhëniet e veta me policëmbajtësit. Ato mund të kërkojnë vetëm njoftim josistematik të këtyre kushteve dhe dokumenteve të tjera, në kuadër të verifikimit të përmbushjes së akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me këto risqe dhe kjo kërkesë nuk mund të përbëjë kusht paraprak për ndërmarrjen që kësaj t'i jepet mundësia të ushtrojë aktivitetet.

Në lidhje me risqet e përmendura në nenin 5 shkronja "d", Shtetet Anëtare nuk mund të mbajnë a të miratojnë njoftim apo aprovim paraprak të rritjeve të propozuara të shkallëve të primeve me përjashtim të një sistemi të përgjithshëm për mbajtjen në kontroll të çmimeve.

Ky bashkërendim nuk i pengon Shtetet Anëtare as t'ua nënshtrojnë ndërmarrjet që kërkojnë ose kanë autorizim për klasën 18 në shkronjën "A" të shtojcës kontrolleve për burimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta në formë të burimeve njerëzore dhe pajisjeve, duke përfshirë edhe plotësimin e kushteve kualifikuese nga ana e ekipeve mjekësore të tyre dhe cilësinë e pajisjeve të cilat u janë vënë në dispozicion ndërmarrjeve për përmbushjen e angazhimeve që u dalin nga kjo klasë e sigurimeve."

#### Neni 10

Në nenin 19 të Direktivës së parë shtohet pika e mëposhtme:

"3. Çdo Shtet Anëtar bën hapat e nevojshme për t'u kujdesur që autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve të sigurimeve të kenë kompetencat dhe mjetet e nevojshme për mbikëqyrjen e veprimtarive të ndërmarrjeve të sigurimeve të vendosura në territorin e vet, duke përfshirë veprimtaritë e angazhuara jashtë këtij territori, në përputhje me direktivat e Këshillit që i rregullojnë këto veprimtari dhe në funksion të kontrollit të zbatimit të tyre.

Këto kompetenca e mjete duhet t'u mundësojnë autoriteteve mbikëqyrëse në veçanti:

- kryerjen e hetimeve të hollësishme për situatën e ndërmarrjes dhe për të gjithë aktivitetin e saj tregtar, ndër të tjera përmes:

- mbledhjes së informacioneve apo duke kërkuar paraqitjen e dokumenteve të lidhura me aktivitetin tregtar të sigurimeve,
- kryerjes së hetimeve në vend në mjediset e ndërmarrjes,
- marrjen e masave, në lidhje me ndërmarrjen, të cilat të jenë të duhura dhe të nevojshme për të siguruar që aktivitetet e ndërmarrjes të mbeten në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të cilat i duhet ndërmarrjes të zbatohet në çdo Shtet Anëtar dhe në veçanti në përputhje me skemën e operacioneve për aq sa kjo skemë mbetet e detyrueshme, dhe për të parandaluar apo eliminuar çdo parregullsi që cenon interesat e policëmbajtësve,
- sigurimin që të zbatohen masat e kërkuara nga autoritetet mbikëqyrëse, nëse është nevoja edhe përmes masave shtrënguese, sipas rastit nëpërmjet kanaleve gjyqësore.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë edhe që autoritetet mbikëqyrëse të marrin çdo informacion në lidhje me kontratat e mbajtura nga ndërmjetësit."

#### Neni 11

1. Neni 21 i Direktivës së parë shfuqizohet.
2. Çdo Shtet Anëtar autorizon, sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin kombëtar, ndërmarrjet që janë vendosur në territorin e tij, t'ia transferojnë një zyre pranuese të vendosur në po atë Shtet Anëtar të gjithë ose një pjesë të portofolave të kontratave për të cilat ky shtet është shteti ku ndodhet risku, nëse autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar ku ndodhet zyra qendrore e zyrës pranuese vërtetojnë se kjo zyrë zotëron nivelin e nevojshëm të aftësisë paguese duke marrë në konsideratë edhe portofolin e transferuar.
3. Çdo Shtet Anëtar autorizon, sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin kombëtar, ndërmarrjet e vendosura në territorin e tij, t'ia transferojnë një zyre pranuese të vendosur në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet të gjitha ose një pjesë të portofolave të kontratave të lidhura në rrethanat e përmendura në nenin 12 pika 1, nëse autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar ku ndodhet zyra qendrore e zyrës pranuese vërtetojnë se kjo zyrë zotëron nivelin e nevojshëm të aftësisë paguese duke marrë në konsideratë edhe portofolin e transferuar.
4. Çdo Shtet Anëtar autorizon, sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin kombëtar, ndërmarrjet e vendosura në territorin e tij, t'ia transferojnë një zyre pranuese të vendosur në të njëjtin Shtet Anëtar të gjitha ose një pjesë të portofolave të kontratave të lidhura në rrethanat e përmendura në nenin 12 pika 1, nëse autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar ku ndodhet zyra qendrore e zyrës pranuese vërtetojnë se kjo zyrë zotëron nivelin e nevojshëm të aftësisë paguese duke marrë në konsideratë edhe portofolin e transferuar dhe nëse zyra në fjalë i përmbush kushtet e parashikuara në nenet nga 13 deri në 16 në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet.
5. Në rastet e përmendura në pikën 3 dhe 4, kalimin e autorizojnë autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar ku është vendosur ndërmarrja që bën kalimin, pasi kanë marrë pëlqimin e autoriteteve mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet.

6. Nëse Shteti Anëtar i autorizon, sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin kombëtar, ndërmarrjet e vendosura në territorin e tij t'ia transferojnë të gjitha ose një pjesë të portofolave të kontratave një zyre pranuese të vendosur në një Shtet Anëtar tjetër që nuk është Shteti Anëtar ku ofrohen shërbimet, Shteti Anëtar sigurohet të jenë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar ku ka zyrën qendrore zyra pranuese vërtetojnë që zyra pranuese zotëron nivelin e nevojshëm të aftësinë paguese edhe pasi është marrë në konsideratë transferimi i portofolit,

- jep pëlqimin Shteti Anëtar ku është vendosur zyra pranuese,

- zyra pranuese i përmbush kushtet e neneve nga 13 deri në 16 në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet, legjislacioni i këtij Shteti Anëtar e parashikon mundësinë e një kalimi të tillë dhe ky Shtet Anëtar jep pëlqimin për transferimin në fjalë.

7. Transferimi i autorizuar në përputhje me këtë nen bëhet publik, sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin kombëtar, në Shtetin Anëtar ku ndodhet risku. Transferimi në fjalë e fiton automatikisht vlefshmërinë kundrejt policëmbajtësve, personave të siguruar dhe çdo personi tjetër me të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga kontratat e transferuara.

Kjo dispozitë nuk e cenon të drejtën e Shteteve Anëtare për t'u dhënë policëmbajtësve mundësinë e anulimit të kontratës brenda një afati të caktuar pas kalimit.

### TITULLI III

#### DISPOZITA TË VEÇANTA PËR LIRINË PËR TË OFRUAR SHËRBIME

##### Neni 12

1. Ky Titull zbatohet kur ndërmarrja, nëpërmjet një subjekti që ndodhet në një Shtet Anëtar, mbulon një risk që ndodhet, sipas kuptimit të nenit 2 shkronja "d", në një Shtet Anëtar tjetër; ky i fundit është Shteti Anëtar ku ofrohen shërbimet, sipas kuptimit të këtij Titulli.

2. Ky Titull nuk zbatohet për transaksionet, ndërmarrjet dhe institucionet për të cilat nuk zbatohet Direktiva e parë, dhe as për risqet që duhen mbuluar nga institucionet e së drejtës publike të përmendura në nenin 4 të Direktivës së parë.

Ky Titull nuk zbatohet për kontratat e sigurimit të klasifikuara në nënpikat e mëposhtme të shkronjës "A" të Shtojcës të Direktivës së parë:

- Nr. 1:

në lidhje me aksidentet në punë,

- Nr. 10:

pa përfshirë përgjegjësinë civile të transportuesit,

- Nr. 12:

në lidhje me motobarkat dhe barkat të cilat Shteti Anëtar në fjalë ua nënshtron të njëjtave rregullime me automjetet motorike tokësore në momentin e njoftimit të kësaj direktive,

- Nr. 13:

në lidhje me përgjegjësinë civile bërthamore dhe përgjegjësinë për produktet farmaceutike,

- Nr. 9 dhe 13:

në lidhje me sigurimin e detyrueshëm të punimeve të ndërtimit.

Këto përjashtime Këshilli do t'i shqyrtojë jo më vonë se data 1 korrik 1998.

3. Në pritje të bashkërendimit të përmendur në nenin 7 pika 2 shkronja "c" të Direktivës së parë, Republika Federale e Gjermanisë mund ta mbajë në fuqi ndalimin e ndërmarrjes së njëkohshme të sigurimit shëndetësor me klasa të tjera në territorin e saj, sipas rregullimeve për ofrimin e shërbimeve.

#### Neni 13

Legjislacioni i Shteteve Anëtare duhet të parashikojë që ndërmarrja e vendosur në një Shtet Anëtar mund të mbulojë brenda atij shteti, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, të paktën:

- risqet e mëdha sipas përkufizimit në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë,

- risqe të ndryshme nga ato që përkufizohen në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë të cilat bien brenda klasave për të cilat nuk ka marrë autorizim gjatë vendosjes në të.

#### Neni 14

Çdo ndërmarrje që synon të ofrojë shërbime informon së pari autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ka zyrën qendrore dhe, sipas rastit, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të subjektit në fjalë, duke bërë të ditur Shtetin Anëtar ose Shtetet Anëtare në territorin e të cilave mendon të ofrojë shërbime, si edhe natyrën e risqeve që propozon të mbulojë.

Këto autoritete mund të kërkojnë dhënien e informacionit ose provave të përmendura në nenin 9 ose 11 të Direktivës së parë.

#### Neni 15

1. Në varësi të dispozitave të nenit 16, çdo Shtet Anëtar në territorin e të cilit synon të ofrojë shërbime ndërmarrja mund ta kushtëzojë ushtrimin e kësaj veprimtarie me marrjen e një autorizimi administrativ; për këtë qëllim, Shteti Anëtar mund të kërkojë që ndërmarrja:

(a) të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ndodhet zyra qendrore, ku vërtetohet se ndërmarrja zotëron për të gjitha veprimtaritë e veta në tërësi nivelin minimal të aftësisë paguese të llogaritur në përputhje me nenin 16 dhe 17 të Direktivës së parë dhe se autorizimi sipas nenit 7 pika 1 të direktivës së lartpërmendur i jep mundësi ndërmarrjes të ushtrimit të aktivitetit jashtë Shtetit Anëtar ku është vendosur;

(b) të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të vendosjes, ku të shprehen klasat në të cilat është autorizuar të ushtrojë veprimtari ndërmarrja dhe ku vërtetohet se autoritetet në fjalë nuk kanë kundërshtim ndaj ofrimit të shërbimeve nga ndërmarrja;

(c) të paraqesë skemën e operacioneve, me të dhënat e mëposhtme: natyrën e risqeve që propozon të mbulojë ndërmarrja në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet,

- kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të policave të sigurimit që propozon të përdorë në të,

- shkallët e primit që parashikon të përdorë ndërmarrja për secilën klasë të aktivitetit tregtar,

- formularët dhe dokumentet e tjera që synon të përdorë në marrëdhëniet e veta me policëmbajtësit, për aq sa këto u kërkohen ndërmarrjeve të vendosura.

2. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet mund të kërkojnë që të dhënat e përmendura në pikën 1 shkronja "c" t'u paraqiten në gjuhën zyrtare të atij shteti.

3. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet kanë afat gjashtë muaj duke filluar nga marrja e dokumenteve të përmendura në pikën 1, për ta dhënë ose refuzuar autorizimin në bazë të përmbushjes apo mospërmbushjes së të dhënave në skemën e operacioneve të paraqitura nga ndërmarrja me aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të zbatueshme në atë shtet.

4. Nëse autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet nuk e kanë marrë vendimin brenda afatit të përmendur në pikën 3, konsiderohet se autorizimi është refuzuar.

5. Çdo vendim për ta refuzuar autorizimin apo për ta refuzuar vërtetimin e përmendur në pikën 1 shkronja "a" dhe "b" duhet të shoqërohet me arsyet specifike dhe t'i komunikohet ndërmarrjes në fjalë.

6. Çdo Shtet Anëtar parashikon të drejtën për ankim pranë gjykatës kundër refuzimit të autorizimit apo kundër refuzimit për të lëshuar vërtetimin e përmendur në pikën 1 shkronja "a" dhe "b".

## Neni 16

1. Çdo Shtet Anëtar në territorin e të cilit ndërmarrja synon të ofrojë shërbime në mbulim të risqeve të përmendura në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë i kërkon ndërmarrjes:

(a) të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ndodhet zyra qendrore, ku vërtetohet se ndërmarrja zotëron për të gjitha veprimtaritë e veta në tërësi nivelin minimal të aftësisë paguese të llogaritur në përputhje me nenin 16 dhe 17 të Direktivës së parë, dhe se autorizimi sipas nenit 7 pika 1 të direktivës së lartpërmendur i jep mundësi ndërmarrjes të ushtrojë veprimtari jashtë Shtetit Anëtar ku është vendosur;

(b) të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të subjektit, ku të shprehen klasat në të cilat është autorizuar të ushtrojë veprimtari ndërmarrja

dhe ku vërtetohet se autoritetet në fjalë nuk kanë kundërshtim për ofrimin e shërbimeve nga ndërmarrja;

(c) të deklarojë natyrën e risqeve që propozon të mbulojë në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet.

2. Çdo Shtet Anëtar parashikon të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës në rast të refuzimit për të lëshuar vërtetimin e përmendur në pikën 1 shkronja "a" dhe "b".

3. Ndërmarrja mund ta fillojë veprimtarinë duke filluar nga data e vërtetuar në të cilën autoritetet e Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet kanë në dispozicion dokumentet e përmendura në pikën 1.

4. Ky nen zbatohet edhe kur Shteti Anëtar, në territorin e të cilit ndërmarrja synon të ofrojë shërbimet në mbulim të risqeve që nuk përfshihen në risqet e përmendura në nenin 5 shkronja "d", nuk e kushtëzon ushtrimin e kësaj veprimtarie me marrjen e një autorizimi administrativ.

#### Neni 17

1. Kur ndërmarrja e përmendur në nenin 14 synon ta ndryshojë informacionin e përmendur në nenin 15 pika 1 shkronja "c" ose në nenin 16 pika 1 shkronja "c", ua paraqet shtesat dhe ndryshimet autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet. Këto shtesa dhe ndryshime hyjnë në fuqi, përkatësisht, në përputhje me nenin 15 pika 3 dhe nenin 16 pika 3.

2. Kur ndërmarrja e përmendur në nenin 14 synon të mbulojë me veprimtaritë e veta edhe risqe të tjera krahas atyre të përmendura në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë, ajo ndjek procedurën e përshkruar në nenin 14 dhe 15.

3. Kur ndërmarrja e përmendur në nenin 14 synon të mbulojë me veprimtaritë e veta edhe risqe të përmendura në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë apo në nenin 16 pika 4 të kësaj direktive, ajo ndjek procedurën e përshkruar në nenin 14 dhe 16.

#### Neni 18

1. Ky bashkërendim nuk i pengon Shtetet Anëtare të mbajnë ose miratojnë akte ligjore, nënligjore ose administrative sidomos në lidhje me aprovimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, aprovimin e formularëve dhe dokumenteve të tjera të shtypura që përdoren në marrëdhëniet me policëmbajtësit, aprovimin e shkallëve të primit dhe të çdo dokumenti tjetër të nevojshëm për ushtrimin normal të mbikëqyrjes, me kusht që rregullat e Shtetit Anëtar të subjektit të mos jenë të mjaftueshme për arritjen e nivelit të nevojshëm të mbrojtjes, dhe që kërkesat ligjore të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme në këtë aspekt.

2. Megjithatë, në lidhje me risqet e përmendura në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë, Shtetet Anëtare nuk parashikojnë dispozita që të kërkojnë aprovimin apo njoftimin sistematik të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të policave, shkallëve të primeve, formularëve e dokumenteve të tjera të shtypura që mendon të përdorë ndërmarrja në marrëdhëniet e veta me policëmbajtësit. Ato mund të kërkojnë vetëm njoftim josistematik të këtyre kushteve dhe

dokumenteve të tjera, në kuadër të verifikimit të përmbushjes së akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me këto risqe, megjithëse kjo kërkesë nuk mund të përbëjë kusht paraprak për ndërmarrjen që kësaj t'i jepet mundësia të ushtrojë veprimtari.

3. Në lidhje me risqet e përmendura në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë, Shtetet Anëtare nuk mund të mbajnë a të miratojnë njoftim apo aprovim paraprak të rritjeve të propozuara të shkallëve të primeve, me përjashtim të një sistemi të përgjithshëm për mbajtjen në kontroll të çmimeve.

## Neni 19

1. Çdo ndërmarrje që ofron shërbime u paraqet autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet të gjitha dokumentet që i kërkohen, në kuadër të zbatimit të këtij neni, për aq sa ndërmarrjet e vendosura janë të detyruara ta bëjnë një gjë të tillë.

2. Nëse autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar konstatojnë se ndërmarrja që ofron shërbime në territorin e tij nuk i përmbush normat ligjore në fuqi në Shtetin në fjalë të cilat janë të zbatueshme për të, këto autoritete i kërkojnë ndërmarrjes në fjalë t'i japë fund parregullsisë.

3. Nëse ndërmarrja në fjalë nuk e përmbush kërkesën e përmendur në pikën 2, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet informojnë për këtë autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të subjektit. Autoritetet e Shtetit Anëtar të subjektit marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që ndërmarrja në fjalë t'i japë fund parregullsisë. Natyra e këtyre masave u komunikohet autoriteteve të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet.

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet mund t'u drejtohen edhe autoriteteve kompetente për zyrën qendrore të ndërmarrjes së sigurimeve, nëse shërbimet i ofrojnë agjenci apo degë.

4. Nëse, me gjithë masat e marra nga Shteti Anëtar i subjektit, ose ngaqë shihet se këto masa nuk janë adekuate ose mungojnë në Shtetin Anëtar në fjalë, ndërmarrja vazhdon t'i shkelë normat ligjore në fuqi në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet, ky i fundit, pasi informon autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar të vendosjes, merr masat e duhura për të penguar parregullsitë e mëtejshme, duke përfshirë, aq sa është e nevojshme, ndalimin e lidhjeve të mëtejshme të kontratave të sigurimit nga kjo ndërmarrje nëpërmjet ofrimit të shërbimeve në territorin e tij. Në rastin e risqeve që nuk përfshihen në risqet e përmendura në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë, në këto masa të tilla përfshihet tërheqja e autorizimit të përmendur në nenin 15. Shtetet Anëtare kujdesen që në territorin e tyre të jetë e mundshme të bëhen njoftimet e duhura për këto masa.

5. Këto dispozita nuk e cenojnë të drejtën e Shteteve Anëtare për ndëshkimin e parregullsive të kryera në territorin e tyre.

6. Nëse ndërmarrja që ka kryer shkeljen ka një subjekt ose zotëron prona në Shtetin Anëtar ku ofrohen shërbimet, autoritetet mbikëqyrëse të këtij të fundit mund të zbatojnë, në përputhje me legjislacionin kombëtar, sanksionet e parashikuara për shkeljen në fjalë duke marrë masa shtrënguese kundër subjektit ose pronave në fjalë.

7. Çdo masë e miratuar sipas pikave nga 2 deri në 6 që përfshijnë sanksione ose kufizime mbi ofrimin e shërbimeve duhet justifikuar rregullisht dhe i duhet komunikuar ndërmarrjes në fjalë. Kundër çdo mase të tillë mund të bëhet ankesë pranë gjykatës në Shtetin Anëtar autoritetet e të cilit e kanë miratuar masën.

8. Kur masat janë marrë sipas nenit 20 të Direktivës së parë, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet informohen për to nga autoriteti që i ka marrë masat dhe, kur masat janë marrë sipas kushteve të pikës 1 dhe 3 të nenit të sipërpërmendur, bëjnë të gjitha hapat e nevojshme për mbrojtjen e personave të siguruar.

Në rast të tërheqjes së autorizimit në bazë të nenit 22 të Direktivës së parë, për këtë informohen autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet, të cilat marrin masat e duhura për të mos lejuar që subjekti në fjalë të vazhdojë të lidhë kontrata sigurimi nëpërmjet ofrimit të shërbimeve në territorin e atij shteti.

9. Çdo dy vjet Komisioni i paraqet Këshillit një raport me një përmbledhje të numrit dhe llojit të rasteve në të cilat, në secilin Shtet Anëtar, janë komunikuar vendime për refuzimin e autorizimeve sipas nenit 15 ose janë marrë masa në përputhje me pikën 4. Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me Komisionin duke i dhënë këtij të fundit informacionin e nevojshëm për këtë raport.

#### Neni 20

Në rast të mbylljes së aktivitetit të një ndërmarrjeje sigurimesh, angazhimet e lindura nga kontratat e nënshkruara në rrjedhën e ofrimit të shërbimeve përmbushen njësoj sikur të kishin lindur nga kontratat e tjera të sigurimeve të ndërmarrjes në fjalë, pa bërë dallim në bazë të shtetësisë sa u takon personave të siguruar dhe përfituesve.

#### Neni 21

1. Kur ofrohen sigurime nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, policëmbajtësi informohet, përpara dhënies së angazhimit, për Shtetin Anëtar në të cilin është vendosur selia, agjencia apo dega me të cilën do të lidhet kontrata.

Informacionin e përmendur në paragrafin e mësipërm duhet ta përmbajë çdo dokument që i lëshohet policëmbajtësit.

Kërkesat e dy paragrafëve të mësipërm nuk zbatohen për risqet e përmendura në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë.

2. Kontrata a çdo dokument tjetër që ofron mbulim, së bashku me propozim-sigurimin kur ky ka fuqi detyruese për propozuesin, duhet të specifikojnë adresën e subjektit siguruës që ofron mbulimin dhe adresën e zyrë qendrore.

#### Neni 22

1. Çdo subjekt duhet të informojë autoritetin e vet mbikëqyrës në lidhje me operacionet e realizuara nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe vlerën e primeve, pa u zbritur risigurimin, që



është e arkëtueshme, e zbërthyer sipas Shteteve Anëtare dhe sipas grupeve të klasave. Grupet e klasave janë si më poshtë:

- aksidente dhe sëmundje (1 dhe 2),
- zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë (8 dhe 9),
- aviacion, marinë dhe transport (3, 4, 5, 6, 7, 11 dhe 12),
- përgjegjësi civile të përgjithshme (13),
- krediti dhe garancia (14 dhe 15),
- klasa të tjera (16, 17 dhe 18).

Autoriteti mbikëqyrës i secilit Shtet Anëtar ua përcjell këtë informacion autoriteteve mbikëqyrëse të secilit prej Shteteve Anëtare ku ofrohen shërbimet.

2. Kur subjekti fiton në një Shtet Anëtar, në lidhje me operacionet e përmendura në paragrafin e parë të pikës 1, një vëllim primesh i cili, pa zbritur risigurimin, e kalon vlerën 2 500 000 Ecu, subjekti duhet të mbajë një llogari të marrjes në sigurim ku të përfshihen zërat e renditura në Shtojcën 2 A ose 2 B, të zbërthyer sipas grupeve të klasave për Shtetin Anëtar në fjalë.

Megjithatë, kur ndërmarrja, me të gjitha subjektet e saj të marra së bashku, fiton në një Shtet Anëtar, në lidhje me operacionet e përmendura në paragrafin e parë të pikës 1, një vëllim primesh i cili, pa zbritur risigurimin, është më i lartë se 2 500 000 Ecu, autoriteti mbikëqyrës i Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet mund t'i kërkojë autoritetit mbikëqyrës të Shtetit Anëtar ku ndodhet zyra qendrore e ndërmarrjes që të mbahet në të ardhmen një llogari e marrjes në sigurim për operacionet e realizuara në vendin e tij nga secili prej subjekteve të ndërmarrjes në fjalë.

Autoriteti mbikëqyrës i Shtetit Anëtar ku është vendosur ndërmarrja i përcjell autoritetit mbikëqyrës të Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet, me kërkesën e këtij të fundit, llogarinë e marrjes në sigurim të përmendur në paragrafin e parë ose të dytë të kësaj pike.

## Neni 23

1. Kur ofrimi i shërbimeve bëhet me autorizim nga Shteti Anëtar ku ofrohen shërbimet, vlera e rezervave teknike të lidhura me kontratat në fjalë përcaktohet, gjer në një harmonizim të mëtjetshëm, nën mbikëqyrjen e Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet në përputhje me rregullat e parashikuara prej tij ose, nëse nuk ka rregulla të tilla, në përputhje me praktikën e njohur në Shtetin Anëtar në fjalë. Mbulimi i këtyre rezervave me aktive të barasvlershme dhe të përputhura, dhe vendndodhja e këtyre aktiveve është nën mbikëqyrjen e Shtetit Anëtar ku ofrohen shërbimet në përputhje me rregullat ose praktikën e tij.

2. Në të gjitha rastet e tjera, përcaktimi i vlerës së rezervave teknike dhe mbulimi i tyre me aktive të barasvlershme dhe të përputhura, dhe vendndodhja e këtyre aktiveve është nën mbikëqyrjen e Shtetit Anëtar të subjektit në përputhje me rregullat ose praktikën e tij.

3. Shteti Anëtar i subjektit kujdeset që rezervat teknike të lidhura me të gjitha kontratat që lidh ndërmarrja nëpërmjet subjektit në fjalë të jenë të mjaftueshme dhe që ato të mbulohen me aktive të barasvlershme dhe të përputhura.

4. Në rastin e përmendur në pikën 1, Shteti Anëtar i subjektit dhe Shteti Anëtar ku ofrohen shërbimet shkëmbejnë të gjitha informacionet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre përkatëse sipas pikës 1 dhe 3.

#### Neni 24

Pavarësisht kësaj direktive, Shtetet Anëtare kanë të drejtë t'u kërkojnë ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet nëpërmjet ofrimit të shërbimeve në territorin e tyre të anëtarësohen dhe të marrin pjesë në skemat e krijuara, me qëllim garantimin e pagimit të dëmeve të sigurimit policëmbajtësve dhe të tretëve të dëmtuar, me të njëjtat kushte me ndërmarrjet e vendosura në to.

#### Neni 25

Pa cenuar asnjë harmonizim të mëpasshëm, çdo kontratë sigurimi e lidhur nëpërmjet ofrimit të shërbimeve u nënshtrohet vetëm tatimeve të tërthorta dhe taksave parafiskale mbi primet e sigurimit në Shtetin Anëtar ku ndodhet risku sipas kuptimit të nenit 2 shkronja "d", si edhe, në rastin e Spanjës, u nënshtrohet edhe taksave shtesë të vendosura ligjërisht në favor të entit spanjoll "Consorcio de compensación de Seguros" për përmbushjen e funksioneve të këtij të fundit në lidhje me dëmshpërblimin e humbjeve që lindin nga ngjarjet e jashtëzakonshme në këtë Shtet Anëtar.

Përrjashtimisht nga nënpika e parë e shkronjës "d" të nenit 2 dhe në funksion të zbatimit të këtij neni, pasuria e luajtshme brenda një ndërtese që ndodhet në territorin e një Shteti Anëtar, me përjashtim të mallrave në transport, quhet risk që ndodhet në atë Shtet Anëtar, edhe sikur ndërtesën dhe përmbajtjen e saj të mos i mbulojë e njëjta policë sigurimi.

Legjislacioni i zbatueshëm për kontratat sipas nenit 7 nuk i cenon rregullimet fiskale të zbatueshme.

Çdo Shtet Anëtar, në varësi të harmonizimit të ardhshëm, zbaton për ndërmarrjet që ofrojnë shërbime në territorin e tij dispozitat e veta kombëtare për masat që sigurojnë mbledhjen e tatimeve të tërthorta dhe taksave parafiskale që kërkohen sipas paragrafit të parë.

#### Neni 26

1. Risqet që mund të mbulohen nëpërmjet bashkësigurimit në Komunitet sipas kuptimit të Direktivës 78/473/KEE janë risqet e përcaktuara në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë.

2. Për siguruesin kryesor zbatohen dispozitat e kësaj direktive në lidhje me risqet e përcaktuara në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë.

#### TITULLI IV

#### RREGULLIME KALIMTARE

##### Neni 27

1. Greqia, Irlanda, Spanja dhe Portugalia mund të zbatojnë rregullimet kalimtare të mëposhtme:

ii(i) deri më 31 dhjetor 1992, mund të zbatojnë për të gjitha risqet regjimin që nuk mbulon risqet e përmendura në nenin 5 shkronja "d" të Direktivës së parë,

i(ii) nga data 1 janar 1993 deri më 31 dhjetor 1994, regjimi për risqet e mëdha zbatohet për risqet e përmendura në nënpikat "i" dhe "ii" të shkronjës "d" të nenit 5 të Direktivës së parë; për risqet e përmendura në nënpikën "iii" të shkronjës "d" të lartpërmendur, këto Shtete Anëtare caktojnë pragjet për t'u zbatuar në atë rast;

(iii) Spanja - nga data 1 janar 1995 deri më 31 dhjetor 1996, zbatohen pragjet e fazës së parë të përshkruar në nenin 5 shkronja "d" nënpika "iii" të Direktivës së parë,

- pas datës 1 janar 1997, zbatohen pragjet e fazës së dytë.

Portugalia, Irlanda dhe Greqia - nga data 1 janar 1995 deri më 31 dhjetor 1998, zbatohen pragjet e fazës së parë të përshkruar në nenin 5 shkronja "d" nënpika "iii" të Direktivës së parë,

- pas datës 1 janar 1999, zbatohen pragjet e fazës së dytë.

Përjashtimi i lejuar pas datës 1 janar 1995 zbatohet vetëm për kontratat që mbulojnë risqet e përfshira në klasat 8, 9, 13 dhe 16 që ndodhen vetëm në njërin prej Shteteve Anëtare që përfitojnë nga rregullimet kalimtare.

2. Deri më 31 dhjetor 1994, neni 26 pika 1 i kësaj direktive nuk zbatohet për risqet që ndodhen në katër Shtetet Anëtare të përcaktuara në këtë nen. Për periudhën kalimtare pas datës 1 janar 1995, risqet e përcaktuara në nenin 5 shkronja "d" nënpika "iii" të Direktivës së parë, të cilat ndodhen në këto Shtete Anëtare dhe të cilat mund të mbulohen me bashkësigurim në Komunitet sipas kuptimit të Direktivës 78/473/KEE, janë ato risqe të cilat i kalojnë pragjet e përmendura në pikën 1 nënpika "iii" të këtij neni.

#### TITULLI V

#### DISPOZITA TË FUNDIT

##### Neni 28

Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare bashkëpunojnë nga afër me qëllim mundësimin e mbikëqyrjes së sigurimeve të drejtpërdrejta brenda Komunitetit.

Çdo Shtet Anëtar e informon Komisionin për çdo vështirësi madhore që lind nga zbatimi i kësaj direktive, ndër të tjera nëse Shteti Anëtar vihet në dijeni të një kalimi jonormal të veprimtarisë tregtare të sigurimeve në dëm të interesave të ndërmarrjeve të vendosura në territorin e tij dhe në fitim të degëve dhe agjencive që ndodhen në anën tjetër të kufijve të tij.

Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në fjalë i shqyrtojnë këto vështirësi sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të gjejnë një zgjidhje të duhur.

Komisioni i paraqet, sipas rastit, propozimet e duhura Këshillit.

#### Neni 29

Komisioni i përcjell Këshillit raporte të rregullta, të parin prej të cilëve më 1 korrik 1998, në lidhje me zhvillimin e tregut të sigurimeve të realizuara sipas kushteve të lirisë për të ofruar shërbime.

#### Neni 30

Kur në këtë direktivë përmendet Ecu-ja, vlera e këmbimit e monedhave kombëtare që duhet përdorur duke filluar nga data 31 dhjetor e çdo viti është vlera që zbatohet në ditën e fundit të muajit tetor të fundit për të cilin mund të gjenden vlerat e këmbimit për Ecu-në në të gjitha monedhat e Komunitetit.

Neni 2 i Direktivës 76/580/KEE (8) zbatohet vetëm për nenin 3, 16 dhe 17 të Direktivës së parë.

#### Neni 31

Çdo pesë vjet, Këshilli, me propozimin e Komisionit, i shqyrton dhe, nëse është nevoja, i ndryshon vlerat e shprehura në Ecu në këtë direktivë, duke marrë në konsideratë ndryshimet e situatës ekonomike dhe monetare të Komunitetit.

#### Neni 32

Shtetet Anëtare bëjnë shtesat dhe ndryshimet përkatëse në dispozitat e tyre kombëtare për ta përmbushur këtë direktivë brenda 18 muajve pas datës së njoftimit të Direktivës [9] dhe e informojnë për këtë Komisionin.

Dispozitat e ndryshuara në përputhje me këtë nen zbatohen brenda 24 muajve pas datës së njoftimit të kësaj direktive.

#### Neni 33

Me të marrë njoftim për këtë direktivë, Shtetet Anëtare kujdesen që t'i komunikohen Komisionit tekstet e akteve kryesore ligjore, nënligjore apo administrative që miratojnë në fushën që mbulon kjo direktivë.

#### Neni 34

Shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj direktive.

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Luksemburg, më 22 qershor 1988.

Për Këshillin

Presidenti M. BANGEMANN

EWG:L333UMBE00.94 FF: 3UEN; SETUP: 01; Hoehe: 5708 mm; 1077 Zeilen; 52104 Zeichen;

Bediener: JUTT Pr.: C

Kunde:

[1] GZ nr. C 32, 12. 2. 1976, fq. 2.

[2] GZ nr. C 36, 13. 2. 1978, fq. 14, GZ nr. C 167, 27. 6. 1988 dhe Vendimi, datë 15 qershor 1988 (i pabotuar ende në Gazetën Zyrtare).

[3] GZ nr. C 204, 30. 8. 1976, fq. 13.

[4] GZ nr. L 228, 16. 8. 1973, fq. 3.

[5] GZ nr. L 185, 4. 7. 1987, fq. 72.

[6] GZ nr. L 151, 7. 6. 1978, fq. 25.

[7] GZ nr. L 193, 18. 7. 1983, fq. 1.

[8] GZ nr. L 189, 13. 9. 1976, fq. 13.

[9] Kjo direktivë u është njoftuar Shteteve Anëtare më 30 qershor 1988.

## SHTOJCA 1

### RREGULLAT E PËRPUTHJES

Monedha me të cilën janë të pagueshme angazhimet e siguruesit përcaktohet në përputhje me rregullat e mëposhtme:

1. Kur mbulimi i parashikuar me kontratë shprehet në formën e një monedhe të caktuar, konsiderohet se angazhimet e siguruesit janë të pagueshme me atë monedhë.
2. Kur mbulimi i parashikuar me kontratë nuk shprehet në formën e një monedhe, konsiderohet se angazhimet e siguruesit janë të pagueshme me monedhën e vendit ku ndodhet risku. Por siguruesi mund ta vendosë vetë monedhën me të cilën shprehet primi, nëse ka arsye të justifikuar për ushtrimin e një të drejte të tillë.

Mund të ndodhte kështu nëse, pas momentit të lidhjes së kontratës, duket se ka të ngjarë që dëmi të paguhet në monedhën e primit dhe jo në monedhën e vendit ku ndodhet risku.

3. Shtetet Anëtare mund ta autorizojnë siguruesin të shikojë mundësinë që monedha me të cilën duhet të ofrojë mbulim të jetë ose monedha që do të përdorë sipas përvojës së fituar ose, në mungesë të kësaj përvoje, monedha e vendit ku është vendosur:

- për kontratat në mbulim të risqeve të klasifikuara në klasat 4, 5, 6, 7, 11, 12 dhe 13 (vetëm përgjegjësia civile e prodhuesit) dhe për kontratat në mbulim të risqeve të klasifikuara në klasat e tjera kur, në përputhje me natyrën e risqeve, mbulimi do të ofrohet me një monedhë që nuk është monedha që do të rezultonte nga zbatimi i procedurave të mësipërme.

4. Kur siguruesit i deklarohet një dëm dhe ky dëm është i pagueshëm me një monedhë të specifikuar që nuk është monedha që del nga zbatimi i procedurave të mësipërme, konsiderohet se angazhimet e siguruesit janë të pagueshme me atë monedhë dhe, në veçanti, me monedhën e vendosur me vendim gjykate ose me marrëveshje ndërmjet siguruesit dhe të siguruarit për shpërblimin e dëmit.

5. Kur dëmi vlerësohet me një monedhë për të cilën siguruesi është paraprakisht në dijeni por që nuk është monedha që rezulton nga zbatimi i procedurave të mësipërme, siguruesi mund t'i konsiderojë angazhimet e veta si të pagueshme me atë monedhë.

6. Shtetet Anëtare mund t'u autorizojnë ndërmarrjeve të mos i mbulojnë rezervat teknike me aktive përputhëse nëse zbatimi i procedurave të mësipërme do të sillte si rezultat që ndërmarrja, pavarësisht nëse është zyrë qendrore apo degë, të detyrohej që, në përmbushje të parimit të përputhjes, të mbante aktive në një monedhë që nuk zë më shumë se 7 për qind të aktiveve ekzistuese në monedha të tjera.

Por:

(a) në rastin e aktiveve të rezervave teknike për përputhje në dhrahmi greke, sterlina irlandeze dhe eskudo portugeze, kjo vlerë nuk mund të jetë më e madhe se:

- 1 milion Ecu gjatë periudhës kalimtare që mbaron më 31 dhjetor 1992,

- 2 milion Ecu nga data 1 janar 1993 deri më 31 dhjetor 1998;

(b) në rastin e aktiveve të rezervave teknike për përputhje në franga belge, franga të Luksemburgut dhe peseta spanjolle, kjo vlerë nuk mund të jetë më e madhe se 2 milion Ecu gjatë periudhës kalimtare që mbaron më 31 dhjetor 1996.

Pas mbarimit të periudhës kalimtare të përcaktuar në shkronjat "a" dhe "b" më lart, për këto monedha, nëse nuk vendos ndryshe Këshilli, zbatohet regjimi i përgjithshëm.

7. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos u kërkojnë ndërmarrjeve, pavarësisht nëse janë zyra qendrore apo degë, të zbatojnë parimin e përputhjes kur angazhimet janë të pagueshme me një monedhë që nuk është monedha e njërit prej Shteteve Anëtare të Komunitetit, nëse investimet në atë monedhë janë të rregulluara, nëse monedha është objekt i kufizimeve mbi

dërgesat apo nëse, për arsye të ngjashme, nuk është e përshtatshme për mbulimin e rezervave teknike.

8. Shtetet Anëtare mund t'i autorizojnë ndërmarrjet, pavarësisht nëse janë zyra qendrore apo degë, të mos mbajnë aktive përputhëse për të mbuluar një vlerë që nuk i kalon 20 për qind të angazhimeve të tyre në një monedhë të caktuar.

Por aktivet gjithsej në të gjitha monedhat së bashku duhet të jenë të paktën sa angazhimet gjithsej në të gjitha monedhat së bashku.

9. Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë që sa herë që një angazhim, sipas procedurave të mësipërme, duhet të mbulohet me aktive të shprehura me monedhën e një Shteti Anëtar, kjo kërkesë konsiderohet se është përmbushur edhe nëse deri në 50 për qind të aktiveve janë të shprehura në Ecu.

EWG:L333UMBE01.96 FF: 3UEN; SETUP: 01; Hoehe: 254 mm; 53 Zeilen; 4293 Zeichen;

Bediener: JUTT Pr.: C

Kunde:

#### SHTOJCA 2 A

#### LLOGARIA E MARRJES NË SIGURIM

1. Primi bruto i fituar gjithsej
2. Kosto e dëmeve gjithsej
3. Kosto komisioni
4. Rezultati bruto i marrjes në sigurim

#### SHTOJCA 2 B

#### LLOGARIA E MARRJES NË SIGURIM

1. Primi bruto për vitin e fundit të marrjes në sigurim
2. Dëme bruto në vitin e fundit të marrjes në sigurim (duke përfshirë edhe rezervat në mbyllje të vitit të marrjes në sigurim)
3. Kosto komisioni
4. Rezultati bruto i marrjes në sigurim EWG:L333UMBE02.97 FF: 3UEN; SETUP: 01; Hoehe: 254 mm; 13 Zeilen; 451 Zeichen;

Bediener: WILU Pr.: C

Kunde: